

PROCESVERBAL

nga vazhdimi i parë i seancës së 9-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 20.03.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi vazhdimin e parë të seancës së 9-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski njoftoi se në seancë do të shqyrtohet Pika nr. 7 nga Rendi i ditës për seancën e 9-të, e cila u anulua, me titull - Propozim-vendim për ndryshim të strukturës së pronësisë të SHTR KLAN MAQEDONI nga Shkupi.

Z. Trajçevski shpjegoi se në përputhje me dilemën e Këshillit nga seanca e 9-të, në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar, pronari i ri ka dorëzuar Deklarata të nënshkruara dhe me këtë janë mënjanuar dilemat që ishin hapur, rreth saj se nëse mund të miratohet ndryshimi i strukturës së pronësisë. Ai shpjegoi se në materialet sipas pikës si shtojcë përmban dhe mendim nga Zyra e Avokatëve.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin lejohet ndryshimi i strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONIA SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup.

Me ndryshimet e propozuara të strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONIA SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, nuk krijohet koncentrim i palejueshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Z. Petrushevski, pas votimit të pronarit të ri i dëshiroi sukses në punën e tij në të ardhmen.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

